

Të nderuar pjesëmarrës,

Ky Sesion pranveror mbi qeverisjen mjedisore vjen ne një moment shume te rëndësishëm te zhvillimit te agjendës mjedisore evropiane. Bashkimi Evropian është këmbëngulës në arritjen e standardeve te mirëqeverisjes dhe nga ky këndvështrim, zbatimi i standardeve mjedisore fiton force, koherence dhe perspektive, duke përfshire dhe u shtrire gjithnjë e me tepe edhe ne vendet e Evropës Juglindore, shtetet kandidate dhe potenciale kandidate për anëtarësim ne BE.

Mirëqeverisja dhe qeverisja e qëndrueshme e mjedisit kane mes tyre një korelacion të fuqishëm, i cili fiton terren edhe përmes bashkëpunimit rajonal, sensibilizimit dhe trajtimit të problemeve të përbashkëta dhe çështjeve mjedisore ndërkufitare.

Konsumi i tepruar i resurseve mjedisore është njëra nga çështjet më problematike në përpjekjet për të arritur një nivel më të lartë të qëndrueshmërisë mjedisore, sikurse mbetet sfida e përjetshme për një baraspeshim në mes të prioriteteve ekologjike, ekonomike dhe sociale te zhvillimit.

Tani qasjet kane ndryshuar. Mirëqenia publike dhe mjedisi, për një kohë të gjatë janë konsideruar si përgjegjësia e vetme e qeverive. Në ditët e sotme, koordinimi tradicional hierarkik i qeverive dhe administratave te tyre është zëvendësuar me mekanizma koordinimi që i ngjajnë një rrjeti dhe qasjes së orientuar drejt tregut, duke inkorporuar nivele të ndryshme shoqërore. Zhvendosja graduale nga drejtimi hierarkik i qeverive, duke përfshirë gjithnjë e me shume aktorë privatë dhe publikë, ka rritur përgjegjësinë për menaxhimin e mjedisit.

Parakusht për një qeverisje efektive mjedisore është mbikëqyrja e fuqishme e politikave te Ekzekutivit. Kjo ka nevojë për përfaqësues të përgjegjshëm të zgjedhur në të gjitha nivelet, si dhe për komisione efektive parlamentare, në gjendje për të përkrahur zhvillimin e politikave të qëndrueshme mjedisore, shqyrtimin e ligjeve dhe rregulloreve të propozuara, monitorimin e efijencës së zbatimit të legjislacionit të miratuar, ndërmarrjen e dëgjimeve hetuese dhe shtim te aktivitetit te ligjvënësve dhe përfaqësuesve të qeverise në rrjetet rajonale.

Tre vjet më parë, edhe pse me eksperience dhe tradite te pakët, si SAI realizuam auditimin e performancës së politikave mjedisore qeveritare. Konstatuam se, megjithëse nga ana strukturore, mjedisi në Shqipëri ka institucione të mirë-organizuara, kemi me dhjetëra hotspot-e (vende me ndotje të lartë) të dokumentuara dhe të pa dokumentuara, të trashëguara nga sistemi komunist, si dhe me dhjetëra hotspot-e apo probleme të tjera mjedisore të krijuara nga industritë ndotëse këto njëzet vitet e fundit. Edhe pse janë vënë re disa përmirësime në landfill-et dhe trajtimin e ujërave të ndotura, progresi ka qenë përgjithësisht minimal dhe në disa vende është vërejtur regres, duke shfaqur një trend të rrezikshëm për mjedisin dhe arritjen e kriterëve mjedisore të BE-së.

Duke treguar pasojat për qytetarët evropianë, auditimet mjedisore në shumë SAI të kontinentit kanë arritur të rrisin ndërgjegjësimin për çështjet mjedisore midis qytetarëve dhe qeverive. Ndërlidhja e pasojave të degradimit mjedisor me çështjet e shëndetit publik ka mundësuar të ngrihen kauza mjedisore, aty ku menaxhimi i dobët rrezikon të ketë pasoja serioze për qytetarët, siç janë siguria e ushqimit, uji i pijshëm dhe ndotja e ajrit.

Edhe pse jemi një SAI i vogël dhe në rrugën e modernizimit të aktivitetit auditues dhe arritjes së plotë të zbatueshmërisë së Standardeve ISSAI në punën tonë, të frymëzuar nga anëtarësimi në Grupin e Punës së Auditimit Mjedisor të EUROSAT-it në vitin 2013, kemi realizuar në këta pesë vite disa auditime mjedisore të rëndësishme. Kemi kuptuar si SAI që auditimet mjedisore mund t'i përkushtohen me sukses shpalosjes së aseteve dhe detyrimeve mjedisore, si dhe pajtueshmërisë me legjislacionin dhe konventat, si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare, duke bashkëvepruar intensivisht me qeverinë, por sidomos me ato segmente qeveritare ne pararoje të përpjekjeve për mirëqeverisje. Prej kësaj, jemi të bindur në dobinë dhe vlerën e shtuar të auditimeve që mund të dedikohen për të matur dhe për të promovuar ekonomikitetin, eficiencën dhe efektivitetin e politikave qeveritare në menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit.

Kemi konkluduar se shkatërrimi i parqeve natyrore, ndotja e ujërave të lumenjve dhe deteve, ndotja e tokës, zhdukja e pyjeve dhe zhdukja e shpejtë e biodiversitetit dhe ekosistemeve mund të jenë të pakthyeshme, nëse vazhdohet me ritmin aktual. Ato

dhe mund të rezultojnë në një rrezik serioz për jetën e qytetareve shqiptare në terma afatgjatë, si dhe një pengesë në integrimin e suksesshëm të Shqipërisë në strukturat evropiane. Kemi kërkuar nga Ministria e Mjedisit e Shqipërisë që të realizojë plotësisht aktet nënligjore përkatëse, kryesisht lidhur me Direktivat e BE-së mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Krimin Mjedisor. Kemi theksuar se përgatitja e pamjaftueshme e qeverisë për të monitoruar dhe vendosur sisteme për të zbutur pasojat negative të parashikuara ose të paparashikuara mbi mjedisin, mund të ndikojë në përkeqësimin e kushteve të jetesës për qytetarin.

Ne si SAI duhet të jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e arritjes së standardeve të mirëqeverisjes në menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit, pasi mund të ndikojmë në jetën e qytetareve vetëm nëse udhëheqim nëpërmjet shembullit. Zbatimi i politikave pro mjedisit në SAI-et tona është një nga shembujt më të mirë që mund të japim.

Unë jam i sigurt se përvojat e mbledhura nga auditimet e kryera në lidhje me qeverisjen mjedisore, si dhe diskutimi i përfshirjes së publikut dhe qytetareve në auditimet mjedisore, do të sjellin vlerë të shtuar në këto dy dite të Sesionit, në përpjekjet tona për të mbrojtur dhe ruajtur, si dhe për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm të mjedisit.

Duke i uruar të gjithë pjesëmarrësve në Sesion suksese!

Ju faleminderit!